



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER**  
**DREJTORIA E PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS**

# RELACION

## PROJEKT ZBATIMI

FASADAT E RRUGËS "KASTRIOT MUÇO", SEGMENTI NGA KRYQËZIMI ME  
RRUGËN "TODI SHKURTA" DERI NË KRYQËZIMIN ME RRUGËN "SKËNDERBEU",  
FIER



## 1.1 Vendndodhja e objektit

Objekti i projektit konsiston në meremetimin dhe lysterjen e fasadave të qytetit në rrugën, FASADAT E RRUGËS "KASTRIOT MUÇO", SEGMENTI NGA KRYQËZIMI ME RRUGËN "TODI SHKURTA" DERI NË KRYQËZIMIN ME RRUGËN "SKËNDERBEU", FIER.

Objekti kufizohet me segmentin rrugor me kufizime si vijon:

- Në Veri nga rruga "Skënderbeu"

-Në Jug sheshi "Todi Shkurta"



*Zona e ndërhyrjes, rruga "Kastriot Muço".*

## 1.2 Gjendja ekzistuese

Fasadat e pallateve që do preken nga ky projekt ndodhen nga të dyja anët e rrugës "Kastriot Muço", e cila fillon nga kryqëzimi me rrugën "Todi Shkurta" dhe mbaron deri në kryqëzimin me rrugën "Skënderbeu". Gjendja aktuale e objekteve është relativisht e dëmtuar si në suva ashtu edhe në bojë. Katet përdhe të objekteve që funksionin e tyre e kanë njësi të tipeve të ndryshme në varësi të bizneseve që ofrojnë shërbime të ndryshme, përveçse janë të degraduar në fasad nuk janë as në linjë fasade arkitekture të njëjtë me njeri-tjetrin. Janë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

lyera me bojëra shumëngjyrëshe dhe ndërhyrjet janë bërë sipas dëshirës së të bizneseve që ofrojnë.



*Pamje nga rruga "Kastrito Muço"*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



*Panje nga rruga "Kastrito Muço"*




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



*Pamje nga rruga "Kastrito Muço"*




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



*Panije nga rruga "Kastrito Muço"*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



*Pamje nga rruga "Kastrito Muço"*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



*Panje nga rruga "Kastrito Muço"*





### 1.3 Qëllimi i Projektit

Qëllimi kryesor është ripërtëritja e fasadave të zones në rrugën “Kastriot Muço”, së marrë në studim dhe rritja e efikasitetit energjetic pasi disa nga pallatet ekzistues që në kohën që janë ndërtuar me tullë dhe aktualisht do të trajtohen me bojë hidroplastike.

### 1.4 Objektivat e projektit:

Projekti restaurimin e fasadave, FASADAT E RRUGËS "KASTRIOT MUÇO", SEGMENTI NGA KRYQËZIMI ME RRUGËN "TODI SHKURTA" DERI NË KRYQËZIMIN ME RRUGËN "SKËNDERBEU", FIER.:

- Bojë hidroplastike cilësi e parë
- Suva e zakonshme fasade
- Mur tulle
- Prishje objekteve ekzistues
- Kasete xingato shkarkimi
- Ulluk vertical shkarkimi

### 1.5 Trajtimi i Fasadave

-Rikonstrukcioni i fasadave do të konsistojë në rikonstrukcionin e objekteve duke ruajtur vlerat arkitektonike të kohës në të cilën janë ndërtuar. Objektet që do të suvatohen pjesërisht ose plotësisht. Katet përdhe do të vishen me pllaka qeramike me qëllim për të ruajtur uniformitetin, ndërsa katet e tjera do të lyhen me bojë hidroplastike cilësia e parë, me kodet përkatëse sipas projektit të bashkangjitur këtij relacioni. Kodet e ngjyrave propozojme që të përzgjidhen sipas katalogut të ngjyrave të firmës. Këtë propozim e bëjmë duke marrë shkas nga projektet e mëparshme të realizuara nga Bashkia Fier.

Tek të gjithë objektet janë parashikuar të vendosen kasete dhe ulluke për shkarkimin e ujërave të shiut.

Për të realizuar uniformizimin e fasadave dhe rikthimin e tyre në identitet janë parashikuar prishje të daljeve në fasadë kryesisht në katin përdhe, hapje të llozhave, heqje të mbulesave me çati apo konstruksione të lehta, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për zgjedhjen e kodeve të ngjyrave gjatë zbatimit si dhe për çdo paqartësi të kontaktohet me projektuesin.

Objekt specifik i cili ka një trajtim më të veçant se të tjerët është objekti nr .5 ose Biblioteka e Fierit. Ai objekt do të trajtohet me meremetim si ato origjinale duke u rindertuar në vende ku është dëmtuar. Për çdo hapë që do të hidhet mbi këtë objekt sygjerohet kontakt me projektuesin.

Punoi:

Ark.Klajdi Hodaj

